

## **SYLLABUS: Bazat e biznesit**

| <b>Të dhëna bazike të lëndës</b>        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|-----------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Njësia akademike:</b>                | Fakulteti Ekonomik                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| <b>Titulli i lëndës:</b>                | Bazat e biznesit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| <b>Niveli:</b>                          | Bachelor                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <b>Statusi lëndës:</b>                  | Obligative                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| <b>Viti i studimeve:</b>                | Viti i parë – semestri i dytë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| <b>Numri i orëve në javë:</b>           | 2+1                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| <b>Vlera në kredi – ECTS:</b>           | 4 ECTS                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| <b>Koha / lokacioni:</b>                | Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Prishtinës<br>“Hasan Prishtina”                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| <b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>           | Prof.Ass.Dr.Sevdie Alshiqi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| <b>Detajet kontaktuese:</b>             | <a href="mailto:sevdie.alshiqi@uni-pr.edu">sevdie.alshiqi@uni-pr.edu</a>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| <b>Përshkrimi i lëndës</b>              | Ky kurs ofron një studim të botës së biznesit. Temat përfshijnë parimet themelore dhe praktikat e biznesit bashkëkohor. Pas përfundimit, studentët duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë një kuptim të koncepteve të biznesit si bazë për studimin e subjekteve të tjera të biznesit. Lënda mbulon temat e mëposhtme: Mjedisi i Biznesit; Pronësia e Biznesit dhe Ndërmarrësia; Menaxhimi dhe Organizimi; Burimet njerëzore; Marketing; Financave dhe Investimeve.                                                                                                   |
| <b>Qëllimet e lëndës:</b>               | Ky modul do t'i pajisë studentët me njohuri për biznesin dhe sipërmarrjen në përgjithësi. Gjithashtu do t'i njoftojë studentët për strukturat qeverisëse të biznesit në botë dhe aplikimi i tyre në Kosovë. Kjo lëndë do të përgatitë studentët që të pajisen me njohuritë bazë për themelimin dhe zhvillimin e një biznesi, me fokus në zhvillimin e biznesit të vogël.                                                                                                                                                                                                |
| <b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b> | Me kompletimin e këtij moduli, studentët do të jenë në gjendje: <ul style="list-style-type: none"><li>• të kuptojnë konceptin e biznesit dhe sipërmarrjes;</li><li>• të kuptojnë zhvillimin dhe specifikat e biznesit në Kosovë;</li><li>• të kuptojnë strukturat e qeverisjes së biznesit;</li><li>• të kuptojnë etikën në biznes dhe përgjegjësinë shoqërore të tij;</li><li>• të kuptojnë rëndësinë dhe zhvillimin e planit të biznesit;</li><li>• të kuptojnë menaxhimin dhe motivimin e burimeve njerëzore;</li><li>• të kuptojnë rëndësinë e raportimit</li></ul> |

|                                                                                                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |           |           |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|-----------|
|                                                                                                            | financiar;<br>• të kuptojnë rëndësinë e ndërmarrjes digjitale.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |           |           |
| Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit) |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |           |           |
| Aktiviteti                                                                                                 | Orë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | Ditë/javë | Gjithësej |
| Ligjërata                                                                                                  | 2                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | 15        | 30        |
| Ushtrime teorike/laboratorike                                                                              | 1                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | 15        | 15        |
| Punë praktike                                                                                              |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |           |           |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet                                                                     | 1                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | 15        | 15        |
| Ushtrime në teren                                                                                          |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |           |           |
| Kollokfiume, seminare                                                                                      | 2                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | 2         | 4         |
| Detyra të shtëpisë                                                                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |           |           |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |           | 20        |
| Përgaditja përfundimtare për provim                                                                        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |           | 16        |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)                                                        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |           |           |
| Projektet, prezentimet ,etj                                                                                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |           |           |
| Totali                                                                                                     |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |           | 100       |
| Metodologjia e mësimdhënies:                                                                               | Metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies:<br>• Në dy orë ligjërata në javë do të shtjellohet materiali mësimor, do të zhvillohet mësim interaktiv duke përfshirë përvojat dhe njohuritë nga fusha e biznesit, diskutimet individuale dhe në grupe, si dhe kohë pas kohe do të organizohen teste të vlerësimit.<br>• Në ushtrime do të zhvillohen diskutime për materien e cila punohet në ligjërata dhe do të prezantohen punimet seminarike.                                                                 |           |           |
| Metodat e vlerësimit:                                                                                      | Metodat e vlerësimit dhe kriteret kaluese: 10% pjesëmarrje aktive në klasë; Përgatitja 30% dhe prezantimi i planit të seminarit / biznesit; Test 1 = 30%; Test 2 = 30%.<br>Mjet konkretizimi / IT: Kompjuter dhe projektues, intervista video me sipërmarrësin dhe menaxherin e biznesit<br>Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të mësimdhënies: 50% e kursit bazohet në teorinë e mësimdhënies, ndërsa 50% organizohet në mënyrë praktike përmes studimeve të rasteve, diskutimit të prezantimeve. |           |           |
| Literatura                                                                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |           |           |
| Literatura bazë:                                                                                           | 1. Ferrell,O.C., Hirt, G., and Ferrell, L. (2013). Business a changing world (9th                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |           |           |

|                           |                                                                                                                                                          |
|---------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                           | ed.). New York, NY: McGraw Hill<br>2. Gaspar, Bierman, Kolari, Hise, Smith, Arreola – Risa: “Hyrje në biznes” , përkthyer nga Jonida Bregu, Tiranë, 2007 |
| <b>Literatura shtesë:</b> | 3. William M. Pride, Robert J. Hughes, Jack R. Kapoor (2013); Business, (12 ed.), South – Western Cengage Learning                                       |

| <b>Plani i dizajnuar i mësim:</b> |                                                        |
|-----------------------------------|--------------------------------------------------------|
| <b>Java</b>                       | <b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>                   |
| <i>Java e parë:</i>               | Syllabusi / Hyrje në lëndë                             |
| <i>Java e dytë:</i>               | Çfarë është biznesi?                                   |
| <i>Java e tretë:</i>              | Mjedisi i Biznesit                                     |
| <i>Java e katërt:</i>             | Qeverisja e biznesit, etika dhe përgjegjësia shoqërore |
| <i>Java e pestë:</i>              | Biznesi i vogël dhe sipërmarrja                        |
| <i>Java e gjashtë:</i>            | Menaxhimi dhe organizimi i biznesit                    |
| <i>Java e shtatë:</i>             | Kollokviumi i parë                                     |
| <i>Java e tetë:</i>               | Menaxhimi i burimeve njerëzore                         |
| <i>Java e nëntë:</i>              | Motivimi dhe udhëheqja e punonjësve                    |
| <i>Java e dhjetë:</i>             | Teoritë bashkëkohore të motivimit                      |
| <i>Java e njëmbëdhjetë:</i>       | Bazat e Marketingut                                    |
| <i>Java e dymbëdhjetë:</i>        | Menaxhimi I operacioneve të biznesit                   |
| <i>Java e trembëdhjetë:</i>       | Sistemi financiar                                      |
| <i>Java e katërmëdhjetë:</i>      | Ndërmarrja dixhitale                                   |
| <i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>      | Kollokviumi i dytë                                     |

| <b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Çdo student që merr pjesë në mashtim në çfaredo mënyrë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: (1) Përdorimi i ligjeratave / rasteve studimore ose përmbledhjeve në çdo formë gjatë provimeve, (2) Kopjimi i përgjigjeve të provimeve, (3) (4) Dhënia dhe / ose marrja e pyetjeve dhe / ose përgjigjeve të provimit, (5) Heqja e provimit nga klasa dhe / ose (6) Dhënia ose marrja e ndihmës në një detyrë që tejkalon atë që lejohet nga tutori juaj nuk do të kalojë provimin. |